



REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ
BASHKIA ROSKOVEC
KOMISIONI I QIRADHÉNIES

Nr. 7266 Prot

Roskovec, më 02/11/2021

**SHPALLJE PUBLIKE
PËR QIRADHÉNIEN E PASURISÉ SHTETËRORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, kreu VI, nenet 801 e në vazhdim; ligjet nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfileozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"; Vendimit nr. 1712, datë 24.12.2008, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.13, datë 26.4.2018 "Për zbatimin e vendimit të këshillit të ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedures dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfileozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 79, datë 30.09.2021 "Për dhënien me qira të tokës së pafrytshme nr. pasurie 198/28 në pronësi të Bashkisë Roskovec"; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë, nr.121, datë 01.01.2021 "Për ngritjen e komisionit dhe fillimin e procedurave për dhënien me qira të tokës së pafrytshme nr. pasurie 198/28 në pronësi të Bashkisë Roskovec";

Bashkia Roskovec shpall procedurën e dhënies me qira të tokës së pafrytshme, të llojit "kënetë", zona kadastrale 2599, me sipërsaqe 4200 m^2 , në pronësi të Bashkisë Roskovec përfituar me certifikatë pronësie nr. 609482, datë 24.04.2013 për shfrytëzimin e saj për veprimtari ekonomike.

Ftohen të gjithë të interesuarit (çdo person fizik dhe juridik, vendas ose i huaj) të depozitojnë kërkeshat e tyre pranë Bashkisë Roskovec brenda datës **15.11.2021, ora 16:00**.

Çdo subjekt i cili kërkon të marrë me qira tokën e pafrytshme të llojit kënetë, ZK 2599, të paraqesë pranë Bashkisë Roskovec:

Dokumentacioni për marrjen me qira, që paraqesin konkurrentët, i dorëzohet komisionit në orën e hapjes së konkurrimit dhe përmban:

- 1- Kërkeshën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore, ku të deklarohet oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurrimit, të parashikuar sipas planit të biznesit.
- 2- Planbiznesin e hollësishëm për vjenien në funksionim të objektit, në të cilin duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm:
 - a)- Identiteti i subjektit kërkues, historiku i aktivitetit që kryen;

- b)- Përshkrimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i burimeve financiare të investimit;
- c)- Analiza e detajuar e afateve kohore, që do të duhen për të realizuar projektin investues, si dhe fazat e përcaktuara të realizimit të tij;
- d)- Niveli i punësimit, që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara.

- 3- Deklaratat në formën e vetëdeklarimit, si më poshtë vijon:
- 4- Deklaratë për të dhënat e NIPT/NUIS të subjektit kërkuar;
- 5- Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- 6- Deklaratë për administratorin dhe subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;
- 7- Në rastet kur subjekti konkurruesh zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte, pronë shtetërore, deklaratë për shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt, të theksojë se nuk ushton aktivitet në objekte shtetërore;
- 8- Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim.

Afati i lidhjes së kontratës për këtë pasuri, përcaktohet nga Ministria e financave dhe Ekonomisë për jo më shumë se 10 vjet.

Çmimi dysheme i dhënies me qira për këtë pasuri, është 6000(gjashtë mijë) lekë/ha, në një vit kalendarik.

Për shpalljen e fituesit, procedura e garës për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të dorëzuara, do të zhvillohet në Bashkinë Roskovec në datën **16.11.2021, ora 09:00**, katër II, salla e mbledhjeve.

Në momentin e hapjes së kërkesë-ofertave mund të marrin pjesë edhe ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre, të pajisur me prokurë dhe dokument identifikimi.

Komisioni i qiradhënieς

Eldison Kocaqi

Drinalda Fejzulla

Edlira Toro

KRYETAR
Majlinda Buçi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETAR
Maksim Goga

